



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2013 prot.

Shkodër, më 31.01. 2025

**VENDIM
Nr. 8 datë 30.01.2025**

“MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MBROJTJES SË BIODIVERSITETIT”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.01.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 27 pika 6, nenin 54 shkronja k të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; në nenin 16 të ligjit Nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, në ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, VKM-në Nr.31 datë 20.01.2016 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit” dhe sipas dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI

1. Të miratojë “Planin vendor të mbrojtjes së biodiversitetit” sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratur me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kundër 9

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.01.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al